



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 159, Datë 20.10.2020

“MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“WENERG” SH.A., PËR BARRËSIM TË ASETEVE (MAKINERI DHE PAJISJE) NË FAVOR  
TË “OTP ALBANIA” SH.A., PËR EFEKT TË RISTRUKTURIMIT TË KREDISË PËR  
FONDET E PËRDORURA ME QËLLIM FINANCIMIN E NDËRTIMIT TË HEC-IT  
“DARDHA 1”.**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20 pika “a”, nenit 44, pika “1”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; në zbatim të nenit 6; nenit 7 dhe nenit 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 109/8 prot, datë 15.10.2020 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Wenerg” sh.a., për lënien barrë të aseteve në favor të bankës “OTP Albania” sh.a.,

**Konstatohet se:**

- Me shkresën e protokolluara në ERE me nr. 383/10 Prot, datë 31.09.2020, shoqëria “Wenerg” sh.a., ka paraqitur kërkesën për miratim për barrësim të aseteve (makineri dhe pajisje të HEC Dardha 1, në favor të bankës “OTP Albania” sh.a..
- Shoqëria “Wenerg” sh.a, është mbajtëse e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, me nr. 104, Seria PV10K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 51, datë 05.07.2010, për një periudhë 30 vjeçare dhe modifikuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 11, datë 06.02.2012, për shkak të optimizimit të skemës hidroenergjetike duke përmirësuar projektin. Është mbajtëse edhe e licencës së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 184, Seria T12P, të miratuar nga ERE me vendimin nr. 137, datë 08.10.2012.
- Midis METE (sot MIE), në cilësinë e Autoritetit kontraktues dhe shoqërisë “Compagnie Nationale du Rhone” (CN’AIR) me cilësinë koncesionarit, është lidhur Kontrata e koncesionit të formës BOT, me nr. 6144 Rep dhe nr. 2021 Kol, datë 18.08.2009.

Aplikimi plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit” si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gërmat: “a”, “b”, “e”, “f”, “g”, **janë plotësuar në mënyrë korrekte.**
- Neni 7 pika 1 gërma “h”, (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve). **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën për ristrukturimin e kredisë që ka nënshkruar me OTP Bank, për të kuptuar më tepër rreth barrësimit të aseteve në këtë moment për efekt të këtij ristrukturimi.
- Neni 7 pika 3, (Subjektet koncensionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncensionit e pjesët që transferojnë tek përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Organit shtetëror të autorizuar (MEI) në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve). **Plotësuar.**
- Neni 7 pika 4, Kërkesa, informacioni dhe dokumentacioni i bashkëlidhur kërkesës, duhet të jenë të nënshkruar nga personi ose personat e autorizuar nga shoqëria që kanë kompetencën për përfaqësimin e personit mbajtës licence apo të kandidatit të propozuar. **Plotësuar.**
- Neni 7 pika 6, Pjesë të dokumentacionit që i licencuari kërkon të mos jenë të hapura për publikim, duhet të specifikohen në kërkesën për transferim, së bashku me arsyet e mosbërjes publike të tyre. **Plotësuar.**
- Qëllimi i kësaj rregullore në zbatim të përcaktimeve të pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 44 të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, është përcaktimi i procedurës dhe dokumentave të nevojshme për miratimin e kërkesave të të licencuarve për shitje, dhënie me qera, transferim, hipotekim, barrë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhim, transmetim, shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Subjekti konçensionar “Wenerg” sha, me kontratë konçesioni të formës BOT me nr. 6144 Rep dhe nr. 2021 Kol, datë 18.08.2009, bazuar në deklaratimet e bëra në Pasqyrat Financiare lidhur me pasqyrimin e aseteve, ka njohur asetet sipas modelit të aktivitet jo-material në zbatim të përcaktimeve të SNK 13 dhe SKK5, por mbështetur në KIRFN 12, subjekti konçensionar duhet të marrë paraprakisht autorizim prej konçensiondhënësit, (ish METE, sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për lënien peng të aseteve, meqënëse kontrolli i konçensiondhënësit mbi çdo interes të mbetur të konsiderueshëm do të kufizonte aftësinë praktike të operatorit (subjekti konçensionar) për të shitur ose dhënë peng infrastrukturën.
- Nisur nga të dhënat e pasqyrave financiare do të kërkohej aplikuesit spjegime në lidhje me aftësinë paguese për shlyerjen e kredisë si dhe llojin e aseteve për të cilat i drejtohet ERE-s më këtë kërkesë për miratim të transferimit të tyre, për qëllime të garantimit të kontratës së kredisë.
- Nga rakordimi me Drejtorinë e Financave rezulton se shoqëria “Wenerg” sh.a. i ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Wenerg” sh.a., për barrësim të aseteve në favor të “OTP Albania” sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë për fondet e përdorura me qëllim financimin e ndërtimit të HEC-it “Dardha 1”.
2. Kërkuesi të dokumentojë dhe argumentojë:
  - a. mundësinë financiare për shlyerjen e kredisë
  - b. marrjen e qëndrimit të MIE në lidhje me transferimin e aseteve të deklaruara në këtë aplikim
  - c. marrëveshjen paraprake të kredisë së dakortësuar për qëllime të këtij aplikimi
3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**